

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 58/00 dhe 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/ 06, 70/06 dhe 51/07), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi program mësimor në lëndën fakultative përparimi i shëndetit për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII, VIII ose IX për arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI MËSIMOR

PËRPARIMI I SHËNDETIT

LËNDË FAKULTATIVE

ARSIMI FILLOR

1. HYRJE

Lënda mësimore *përparimi i shëndetit* është lëndë fakultative për nxënësit e shkollës fillore nëntëvjeçare. Lënda mësimore u ofrohet nxënësve në periudhën e tretë të shkollës fillore në klasën e VII, VII ose të IX. Fondi javor për këtë lëndë është 2 orë në javë, përkatësisht 72 orë gjatë një vitit shkollor.

Lënda mësimore *përparimi i shëndetit* bazohet në konceptin global për shëndetin si tërësi të shëndetit fizik, mental dhe social (nëpërmjet bindjeve, qëndrimeve dhe sjelljes të individit (si pjesë e bashkësisë, si dhe mundësitë e mjedisit), ndërsa nënkupton dhe pjesëmarrje aktive të çdo individit në krijimin e tij. Me fjalë të tjera, ajo do të thotë përfshirje kompetente dhe personale të nxënësit në ndërtimin e stilit të shëndoshë jetësor, i vetëdijshëm për nevojat e veta, për shprehitë, për veçoritë kulturore dhe për mundësitë (vetjake dhe ato të bashkësisë) të marr pjesë në këtë proces.

Ndërtimi i stilit të shëndoshë të jetës në kontekstin konceptit të ri për shëndetin dhe strategjitë e reja për përparimin e tij, parashikon pjesëmarrje aktive të individit (nxënësit) në shumë procese; nga procesi informimit, diskutimet për rëndësinë, shqyrtimi dhe zgjedhja e alternativave, zgjedhja e strategjive, ndërmarrja e aksioneve, tejkalimi i pengesave të mundshme etj. Në kontekstin e tillë aksion, marrja e vendimeve për vete dhe për ambientin përreth e jep komponentin kryesor. Ky quhet mësim për të qenë kompetent për të vepruar në sferën e përparimit të shëndetit dhe të mjedisit social, si dhe të ndërmerren aksione me karakter human.

Lënda mësimore përparimi i shëndetit realizohet nëpërmjet projekteve që i zgjedhin nxënësit.

SHËNIM:

Në pajtim me dinamikën për futjen e edukimit dhe arsimimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës të VI të arsimit fillor tetëvjeçar të vitit shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, të VIII ose të IX të arsimit fillor nëntëvjeçar.

2. SYNIMET E MËSIMIT PËR KLASËN E VII, VIII OSE TË IX

Nxënësi/ nxënësjë:

- të aftësohet për të vepruar në sferën e përparimit të shëndetit;
- të marrë njohuri për konceptin holistik për shëndetin;
- të aftësohet të bëjë dallimin midis qasje tradicionale dhe humaniste në arsimin shëndetësor;
- të di të përzgjedh temë për hulumtim, të përgatis plan hulumtues dhe t'i përmbledh dhe prezantoj të dhënat e hulumtimit;
- të di të përgatis projekt nga fusha e përparimit të shëndetit;
- të nxitet për pjesëmarrje humanitare në bashkësi;
- të aftësohet të bashkëpunoj dhe punoj në ekip;
- të nxitet ta rris cilësinë e jetës, për përparimin e shëndetit personal dhe social dhe të ambientin të shëndoshë në shkollë dhe në bashkësinë lokale;
- të aftësohet t'i shfrytëzoj shërbimet dhe të bashkëpunoj me institucionet që merren me probleme nga fusha e shëndetit, dhe kënaqjen e nevojave të grupeve të ndryshme specifike.

3. SYNIME KONKRETE

KONCEPTI PËR SHËNDETIN (12 orë)			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivite dhe metoda
<p>Nxënësi/ nxënësja</p> <p>-të njihet me principin holistik të shëndetit (si gjendje e mirëqenies komplete fizike, psikike dhe sociale).</p>	<p>Çfarë është shëndeti?</p>	<p>Shëndeti</p>	<p>Atelie: çfarë është shëndeti? Nxënësit ndahen në grupe prej 4 deri në 5 persona. Çdo grup duhet t'i shkruaj në një fletë mendimet e veta për njëren prej pyetjeve?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është person i shëndetsihëm? - Çfarë është familje e shëndetsihme? - Çfarë është shkollë e shëndetsihme? <p>Më pas çdo grup i prezanton mendimet e veta para të tjerëve. Mbas çdo prezantimi diskutohet për pyetjen: A kanë për të shtuar të tjerët ndonjë gjë? A ka qëndrime të kundërta?</p>
<p>-Të njihet me lidhjet midis shëndetit mental, emocional, social dhe fizik dhe pasojat nga prisja e raportit midis këtyre komponentëve.</p>	<p>Raporti: shëndet-ndjenja-mendime-sjellje sociale</p>	<p>Shëndeti mental dhe emocional Shëndeti social dhe fizik</p>	<p>-Prezantimi i termave: shëndet mental, emocional dhe social.</p> <ul style="list-style-type: none"> - diskutim për raportin e këtyre komponentëve. -Foto <p>-Nxënësit ndahen në katër grupe, çdo grup merr një fletë të madhe letre, marker dhe një fotografi djali apo vajze.</p> <p>Fotografinë e ngjisin në qendër të letrës. Detyra e tyre është të shkruajnë në letër çfarë mendojnë për fëmijën në fotografi: se mendon, ndjen, me kë shoqërohet? I shkruajnë të gjithë idetë.</p> <p>-vijon diskutim.</p>
<p>-T'i kuptoj ndikimet e familjes, shkollës, shoqërisë dhe të ambientit natyror mbi shëndetin e individit.</p>	<p>Ndikimi i mjedisit mbi shëndetin</p>	<p>Burime ndikimi mbi shëndetin</p>	<p>-Grupimi i burimeve të ndikimit mbi shëndetin – kushtet e mjedisit.</p>

<p>-Të njihet me mënyrat sesi ndikojnë politika publike, shëndetësore dhe sociale në përmirësimin e shëndetit.</p>	<p>Cilat institucione kujdesen për shëndetin tona dhe si? Si t'i realizoj të drejtat e mia për ruajtjen e shëndetit.</p>	<p>E drejta e mbrojtjes shëndetësore</p>	<p>-Mënyra të përparimit të shëndetit – kërkim dokumentesh dhe rolet e institucioneve dhe prezantimi në pllakate murale.</p>
<p>-Të njihet me mënyrat e shëndosha të sjelljes dhe t'i dalloj nga mënyrat e rrezikshme të sjelljes; -ta pranoj se ka përgjegjësi personale në marrjen e vendimit për konsumimin e drogave dhe substancave të tjera psikotrope.</p>	<p>Sjellje të rrezikshme që e dëmtojnë shëndetin</p>	<p>Sjellje të rrezikshme- pirja e alkoolit, pirja e duhanit, përdorimi i drogës, marrëdhënie të rrezikshme seksuale</p>	<p>-Diskutim: çfarë nënkuptohet me sjellje të rrezikshme? Cilat janë arsyet dhe cilat janë pasojat e sjelljes të rrezikshme? -Debat për ndikimin e individit (përgjegjësi personale) mbi shëndetin personal.</p>

PRINCIPE TË PËRPARIMIT TË SHËNDETIT (8 orë)			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/ nxënësjë</p> <p>-të njihet me qasjen tradicionale dhe humanitare në arsimin shëndetësor;</p> <p>-të aftësohet mbi bazën e sjelljes (vetjake dhe të tjerëve) të zhvilloj strategji për përparimin e shëndetit.</p>	<p>Qasjen tradicionale dhe humanitare në arsimin shëndetësor</p> <p>Strategji për përparimin e shëndetit</p>	<p>Qasjen tradicionale dhe humanitare në arsimin shëndetësor</p> <p>Strategji për përparimin e shëndetit</p>	<p>Luajtje rolesh sipas skenarit të të dy koncepteve të shëndetit – humanitar dhe tradicional.</p> <p>Vendosja e synimeve dhe planifikim – si baza të bërjes të strategjive për përparimin e shëndetit.</p>
<p>-Të aftësohet t'i zbuloj potencialet për përparimin e shëndetit të familjes, shkollës dhe bashkësisë më të gjerë.</p>	<p>Potenciale për përparimin e shëndetit</p>	<p>Potenciale për përparimin e shëndetit</p>	<p>Diskutim – Si mund të ndikojmë në mjedisin tonë të jetesës? Si ndodhin ndryshimet? Si të marr pjesë në bërjen e ndryshimeve pozitive? Ese.</p>

KOMPETENCË PËR AKSION – 16 orë			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
<p>Nxënësi/ nxënësjë</p> <p>-të aftësohet t'i identifikoj problemet nga fusha e përparimit të shëndetit, cilat janë karakteristikat e tyre dhe cilat janë mundësitë për zgjidhjen e tyre.</p>	<p>Komponentë të kompetencës për aksion (njohuri, përkushtim, vizion dhe përvojë në aksion)</p>	<p>Njohuri</p> <p>Përkushtim</p> <p>Vizion dhe Përvojë në aksion</p>	<p>-Lumë idesh për problemet e lidhura me shëndetin.</p> <p>-Diskutim për to nëpërmjet pyetjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përse kjo është e rëndësishme për mua/ne? • Çfarë mundem dhe dua të bëj?
<p>-të aftësohet të përzgjedh problem nga fusha e përparimit të shëndetit i cili është aktual për të dhe për rrethin e tij.</p> <p>-të aftësohet të vendos synime për hulumtimin e problemeve të zgjedhura;</p> <p>-të aftësohet të bëj plan hulumtues (çfarë, si, kur dhe si do të hulumtohet);</p> <p>-të aftësohet t'i parashikoj pengesat dhe të gjej strategji për tejkalimin e tyre;</p> <p>-të aftësohet t'i përmbledh, analizoj dhe prezantoj të dhënat e hulumtimit;</p> <p>-të aftësohet të inicioj ndryshim konkret dhe të ndër marr hapa për realizimin e tij (ndryshimi i stilit të jetës, përmirësimi i kushteve në shkollë, përmirësimi i kushteve që janë të rrezikshme për shëndetin në rajon, përfshirja e personave me nevoja të veçanta në segmente të caktuara të jetës;</p> <p>-të aftësohet të jap vlerësim për aktivitete të realizuara.</p>	<p>Përzgjedhje</p> <p>Hulumtim</p> <p>Aksion</p> <p>Ndryshim</p>	<p>Përzgjedhje</p> <p>Hulumtim</p> <p>Aksion</p> <p>Ndryshim</p>	<p>-Pyetje prioritesh. Zgjedhja e problemit-temë.</p> <p>-Konsultim me literaturë dhe hulumtim në këtë fushë.</p> <p>-Bërja e pyetje hulumtuese.</p> <p>-Zgjedhje resursesh dhe metodash hulumtimi.</p> <p>-Zbatimi i hulumtimit.</p> <p>-Përpunimi i të dhënave të hulumtimit.</p> <p>-Prezantimi i të dhënave të hulumtimit.</p> <p>-Përcaktimi i synimit për aksion.</p> <p>-Hartimi i planit për aksion</p> <p>-Zbatimi i aksionit</p> <p>-Diskutim dhe vlerësimi i ndryshimeve.</p>

PROJEKTE TË NXËNËSVE PËR PËRPARIMIN E SHËNDETIT - 36 orë			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/ nxënësja -të marr pjesë në të gjitha fazat e projekteve të nxënësve për përparimin e shëndetit (përzgjedhje, hulumtim, aksion dhe ndryshim).	Projekte të nxënësve për përparimin e shëndetit	Projekt nxënësish	Në kuadër të një klase nxënësit zgjedhin së shumti dy tema (ose dy deri në tre aspekte të një teme) në të cilën punojnë projekt për përparimin e shëndetit.

PARANDALIMI I HIV/SIDA/ITS			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/ nxënësja -të njihet me faktet për HIV/SIDA-n si problem personal, shoqëror dhe botëror; -të marr njohuri për HIV-infeksionin, sëmundjen e SIDA-s; -të dalloj sjelljen e rrezikshme nga atë të sigurt; -ta kuptoj rëndësinë e HIV testimit dhe mundësitë për parandalimin e infektimit me HIV; -të informohet për infeksionet që transmetohen seksualisht (ITS); -ta kuptoj rëndësinë e parandalimit të ITS; -të ndërtoj dhe mbroj qëndrime personale për jetë të shëndoshë seksuale, për sjelljen e	Definime për shëndet reprodaktiv dhe seksual Fakte për HIV/SIDA Parandalimi i HIV/SIDA Fakte për infeksionet që transmetohen më shpesh nëpërmjet seksit Parandalimi i infeksioneve që transmetohen	Epidemi HIV-virusi Rrugë të transmetueshme Infeksion SIDA HIV test Infeksioneve që transmetohen seksualisht Morra gjenitale Infeksione bakteriale	Hulumtim -Hulumtim sa janë të informuar nxënësit për parandalimin e HIV/SIDA/ITS, -Biseda për shëndet reprodaktiv dhe seksual. -Aftësimi për diskutim publik dhe të hapur për seksualitetin, reproduksionin dhe faktet për HIV/SIDA/ITS. -Shqyrtimi i materialeve të ndryshme: vizatime, fotografi, filma për rreziqet nga HIV/SIDA/ITS. -Shfrytëzimi i informacioneve plotësuese për informim (literaturë, ndihmë nga ekspert, Interneti) Aksion -hartimi i planit për aktivitetin (përmbajtja, qëllimi, detyra, afate). -Anketimi dhe intervistomi i nxënësve për

përgjegjshme/e rrezikshme de parandalimin e HIV/SIDA/ITS.	seksualisht (ITS)	Infeksione nga propozoi Infeksione virusale	informimin e tyre për masat parandaluese nga HIV/SIDA/ITS. -Përpunimi i rezultateve dhe përpilimi i tekstit për prezantim. -Bërja e pllakate informative, informator mural, fletushka informative, broshura për parandalimin e HIV/SIDA/ITS.
---	-------------------	--	--

PARANDALIMI I TUBERKULOZIT			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/ nxënësja -të njihet me faktet për tuberkulozin (TB) si problem personal, shoqëror dhe botëror; -të marr njohuri për tuberkulozin si sëmundje e rëndë infektive; -t'i kuptoj arsyet dhe pasojat nga tuberkulozi; -ta kuptoj rëndësinë zbulimit në kohë dhe të shërimit të plotë nga tuberkulozi; -ta kuptoj rëndësi e parandalimit (mbrojtja) të tuberkulozit; -të ndërtoj qëndrime për jetë të shëndoshë dhe të zbatoj masa për parandalimin e tuberkulozit.	Fakte për tuberkulozin Masa parandaluese kundër tuberkulozit	Epidemi Bakter tuberkulozi Rrugë të transmetimit Infeksion Masa parandaluese Vaksinim	Hulumtim: -Hulumtim sa janë të informuar nxënësit për parandalimin e tuberkulozit, -Biseda për rreziqet dhe masat parandaluese nga tuberkulozi, zgjedhja e përmbajtjes të projektit. -Aftësimi për diskutim publik dhe të hapur për problem shëndetësor personal – tuberkulozi. -Shqyrtimi i materialeve të ndryshme: vizatime, fotografi, filma për rreziqet nga tuberkulozi. -Shfrytëzimi i informacioneve plotësuese për informim (literaturë, ndihmë nga ekspert, Interneti) Aksion -hartimi i planit për aktivitetin (përmbajtja, qëllimi, detyra, afate). -Anketimi i nxënësve për informimin e tyre për masat parandaluese nga tuberkulozit (p.sh:

			vaksinimi, rivaksinimi, grafi etj.) -Përpunimi i rezultateve dhe përpilimi i tekstit për prezantim. -Bërja e pllakate informative, informator mural, fletushka informative, broshura për parandalimin e tuberkulozit -Biseda për ide për vazhdimin e hulumtimit/aksionit.
--	--	--	--

PARANDALIMI I SËMUNDJEVE VARTËSE			
Synime	Përmbajtje	Terma	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/ nxënësja -t'i di pasojat për veten dhe për të tjerët nga konsumimi i duhanit, alkoolit dhe drogave të tjera; -të di t'i vlerësoj rreziqet për shëndetin në rast të përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave të tjera; -të mund t'i dalloj rrethanat dhe faktorët që nxisin në pirjen e duhanit, alkoolit dhe drogave të tjera; -ta kuptoj nevojën e kundërshtimit aktiv (personale dhe kolektive) të përdorimit të drogave (pjesëmarrje në fushata, projekte); -ta rëndësinë e veprimit parandalues kundrejt sëmundjeve vartëse.	Sëmundje vartëse: -drogat -alkooli -nikotina Propozim-projekte: 1. Ndikimi i dëmshëm i drogave. 2. të rinjtë dhe pirja e duhanit 3. Pasojat nga konsumimi i alkoolit dhe alkoolizimi.	Sëmundje vartëse Vartësia nga drogat Simptoma të konsumimit të drogave Alkoolizmi Vartësia nga duhani Masa parandaluese Kurimi nga sëmundjet vartëse	-Hulumtim i një sëmundjeje vartëse sipas zgjedhjes të nxënësve. -hartimi i planit të hulumtimit (zgjedhja e projektit, metoda dhe procedura, detyra, afate, bashkëpunim dhe ndihmë nga institucionet dhe ekspert që merren me këtë problematikë). -Shfrytëzimi i informacioneve plotësuese për informim (literaturë, ndihmë nga ekspert, Interneti) -Bërja e pyetjeve hulumtuese; -zgjedhja e resurseve dhe metodave për hulumtim; -zbatimi i hulumtimit -prezantimi i të dhënave të hulumtimit. - Biseda për ide për vazhdimin e hulumtimit/aksionit. Aksion -përcaktimi i qëllimit të aksionit; -hartimi i plan-aksionit; -zbatimi i aksionit. -Bërja e pllakate informative, informator

			<p>mural, fletushka informative, broshura për parandalimin e sëmundjes vartëse të hulumtuar.</p> <p>-Diskutime dhe vlerësimi i ndryshimeve, mundësive dhe rrugëve të parandalimit.</p>
--	--	--	--

4. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Aktivitetet në kuadër të lëndës mësimore përparimi i shëndetit janë në lidhje me përmbajtjet e lëndëve të veçanta mësimore, megjithatë vetëm ato mund të sigurojnë hyrje sistematike të nxënësve në përmbajtjet dhe mënyrat e përfshirjes të tyre në përparimin e shëndetit dhe angazhimin humanitar dhe mund t'i lidhin dhe t'i integrojnë përmbajtjet dhe aktivitetet si pjesë e një koncepti më të gjerë për shëndetin që nënkupton:

- Metoda dhe forma interaktive pune me fokus tek proceset, në vend se tek përmbajtjet të cilat janë të pjesshme dhe të orientuar për nga nxënësi;
- Pjesëmarrje autentike- zhvillimi i pavarësisë dhe të autonomisë të nxënësve, vetëdija e tyre kritike të ballafaqohen me ndikimet komplekse në jetën e tyre dhe në botë më gjerë në mënyrë kompetente, kreative dhe të lirë;
- Organizim dhe drejtim demokratik- pjesëmarrje e nxënësve në vendosjen e procedurave, strategjive dhe vendime për pjesëmarrje në jetën e shkollës, transparencë e normave të sjelljes dhe informacionet në nivel shkolle dhe angazhimi në bashkësinë lokale dhe atë më të gjerë;
- Bashkëpunim dhe ndërlidhje – të shqyrtohen strukturat shkollore në nivel shkolle, të bashkëpunohet me bashkësinë lokale, me shkolla të tjera, me organizata (qeveritare dhe joqeveritare) që merren me probleme të shëndetit, mjedisit jetësor dhe aktivitete humanitare.

Gjatë semestrit të parë nxënësit marrin pjesë në atelie dhe diskutime të drejtuara nga mësuesi, njihen me konceptin e shëndetit dhe të përparimit të shëndetit , ndërsa në semestrin dytë të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në projekte për

përparimin e shëndetit. Në kuadër të një klase mësuesi drejton së shumti dy projekte me nxënësit ose tre aspekte nga i njëjti projekt.

Drejtime për lidhshmëri midis lëndëve (planifikim i integruar, përkatësisht ndërlidhje qëllimore dhe në përmbajtje me lëndë dhe fusha ta ngjashme)

Në planifikim e programit mësimor theksohet ndërlidhja e mësimit me përvojën e nxënësve, si dhe ndërlidhjen midis lëndëve në lidhje me synimet dhe përmbajtjet. Në atë mënyrë arrihet ndërthurje me e mirë me lëndët e tjera, nga njëra anë, dhe kooperativitet në procesin e mësimdhënies dhe përvetësimit të mësimit, nga ana tjetër.

Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve (planifikim i orientuar i orëve të mësimit sipas temave tërësive mësimore)

Rekomandimet për fondin vjetor të orëve janë dhënë në mënyrë orientuese, bashkë me qëllime dhe tema/përmbajtje konkrete, që sigurisht, nuk dihet ta kufizojnë shpërndarjen e tyre , sipas nevojave gjatë realizimit. Shfrytëzimin ndryshe të orëve të mësimit duhet ta vlerësoj mësuesi i lëndës sipas arritjeve të nxënësve të tij,

Mjete mësimore:

- udhëzues për mësuesin;
- Burime të ndryshme mësimi (tekste, fotografi, burime arkeologjike etj.);
- enciklopedi, fjalorë, atlase, harta etj.;
- Internet, softuerë arsimor të ilustruar;
- revista;
- mjete audio-vizuale dhe mjete të tjera në varësi të lëndës;-

5 VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Ndjekja e ecurisë të nxënësve

Gjatë orës të mësimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen ecuritë e nxënësve, mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, ndiqet motivimi për të mësuar, bashkëpunimi me nxënësit e tjerë etj. (vlerësim formativ).

Ky komponent është pjesë përbërëse e punës të mësuesit dhe të mësimit të nxënësit.

Në program janë të shënuara mënyra të ndjekjes, kontrollit dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve në kuadër të temave mësimore.

Mënyra të kontrollit dhe të vlerësimit:

- Pjesëmarrje aktive ne projekte hulumtuese;
- Prezantim;

Mjete dhe procedura të tjera të ndjekjes dhe vlerësimit:

- Bisedë/dialog mësues-nxënës, si dhe nxënës-nxënës;
- Punë kërkimore (mbledhja e të dhënave për punën kërkimore).

Gjatë dhe në fund të vitit mësuesi i ndjek arritjet e çdo nxënësi në veçanti dhe e vlerëson me notë përkatëse.

6 KUSHTE E AMBIENTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi në lidhje me kushtet e ambienteve bazohet në Normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

7 NORMATIVA PËR KUADROT MËSIMDHËNËS

Puna edukativo-arsimore në lëndën përparimi i shëndetit mund ta realizoj mësues që ka përfunduar fakultetin e psikologjisë ose mësues që ka përfunduar fakultetin e bio-kimisë, FSHN; fakultetin e biologjisë –drejtimi mësues; fakultetin pedagogjik ose akademinë pedagogjike, drejtimi bio-kimi.

8 REZULTATET E PRITURA

Nxënësi / nxënësja:

- E di çfarë është koncepti holistik i shëndetit;
- bën dallimin midis qasje tradicionale dhe humaniste në arsimin shëndetësor;
- di të përzgjedh temë për hulumtim, të përgatis plan hulumtues dhe t'i përmbledh dhe prezantoj të dhënat e hulumtimit;
- di të përgatis projekt nga fusha e përparimit i shëndetit;
- mund të dalloj nevojë për pjesëmarrje humanitare në bashkësi;
- bashkëpunon dhe punon në ekip;
- mund të përmend mënyra për rritjen cilësinë e jetës, për përparimin e shëndetit personal dhe social dhe të ambientin të shëndoshë në shkollë dhe në bashkësinë lokale;
- di t'i shfrytëzoj shërbimet dhe të bashkëpunoj me institucionet që merren me probleme nga fusha e shëndetit, dhe kënaqjen e nevojave të grupeve të ndryshme specifike.

9 KOMISIONI QË E PËRGATITI PROGRAMIN MËSIMOR

1. Mitko Çeshllarov, këshilltar në Entin për zhvillim të arsimit - koordinator
2. Svetllana Brashnarska, këshilltar në Entin për zhvillim të arsimit
3. Zhaneta Çonteva –Shkup,koordinator i projektit të UNICEF-it
4. Prof. d-r Snezhana Adamçevska, Fakulteti filozofik – Instituti i pedagogjisë – Shkup – kryetare
5. Ana Bllazhevska, SYGS “Marija Kiri-Sklodovska” – Shkup
6. Sonja Rulevska, SHF “Naum Ohridski”, f. Bullaçani - Shkup

10 VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programin mësimor për lëndën *projekte nga përparimi i shëndetit* për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e solli

Ministri

data _____

-